

VENDIM
Nr.855, datë 21.10.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.586, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË, CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE
PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 9, të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalëve “... apo fëmijëve të policëve ...” shtohen “... dhe ushtarakëve të Forcave të Armatosura...”.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha